



Pranuar / Dorezuar Prijmjen/Prodato Received/Delivered	24.08	2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Pr. Prot Prot No	Shtojça Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SHKOMBICK	5803/2023		1/4	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1005/2023

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare; Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; Ardita Percuku Shyti, zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1005/2023, të datës 19.07.2022, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1; nenin 16, paragrafi 3; nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2; të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 24.08.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1005/2023, e datës 19.07.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Obligohet** Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesit t’i njoh të drejtën e shfrytëzimit të shtatë (7) ditëve të pushimit vjetor të bartura nga viti 2022, në periudhën e mbetur të vitit 2023.
- III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Nëpunësi civil (tutje vetëm ankuesi), i punësuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, më datë 19.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos aprovimit të kërkesës për pushimin vjetor, nga udhëheqësi i drejtpërdrejt i tij.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Ndërsa, kjo e fundit, më datë 31.07.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me provat lidhur me këtë çështje juridike.

***Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:*** Ankesën me numër protokolli 5279/2023 të datës 19.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 19.06.2023- kërkesa për pushim vjetor nga ankuesi; Vendim për pushim vjetor prej datës 21/06/2023 deri më 30/06/2023 ; E-maili i datës 20.06.2023 nga Kryeshefi për ankuesin; E-maili i datës 20.06.2023 nga ankuesi për Zv.Kryeshefin Ekzekutiv; E-maili i datës 19.06.2023 nga Kryeshefi për ankuesin; E-maili i datës 19.06.2023 nga ankuesi për Kryeshefin; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 24.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 31.07.2023 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës: Akt Emërimi me nr.04-051-802 i datës 16.09.2013 për Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit me nr.04/052/93 i datës 19.02.2015 për transfer; Vendimi për transfer me nr.04-052-89 i datës 19.02.2015 i lëshuar nga Kryeshefi Ekzekutiv; shkresë me numër protokolli 01-796-2023 e datës 07.07.2023 nga Kryeshefi Ekzekutiv për Ministrin e MFPT lidhur me ndarjen e mjeteve shtese për vëllimin të punës shtesë; Lista e stafit të ASK-së për angazhim në regjistrimin e popullsisë për periudhën korrik-dhjetor 2023; E-maili i datës 07.07.2023 nga Kryeshefi i ASK-së për Ministrin e MFPT dhe shtesat e vitit 2021, 2022 dhe 2023 për ankuesin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, ***është e bazuar, sepse:***

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe së i njëjti ushtron pozitën e punës me titull “Zyrtar Certifikues”.

Ankuesi më datë 13.06.2023 ka parashtruar kërkesë për pushim vjetor të bartura nga viti 2022, në kohëzgjatje prej shtatë (7) ditëve dhe atë për periudhën e shfrytëzimit nga data 21.06.2023 deri më datë 30.06.2023.

Duke qenë së ankuesi nuk ka papranuar asnjë konfirmim nga mbikëqyrëse i tij i drejtpërdrejt lidhur me kërkesën e datës 13.06.2023, serish me datë 19.06.2023, inicion kërkesën e njëjtë, ndërsa Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt, po më datë 19.06.2023, ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyetimin se : *kërkesa refuzohet për shkak së kemi angazhime ne Projektin e Regjistrimit te Popullsisë. Me raste konsiderojmë te nevojshme te jeni i angazhuar edhe ju.”*

Pas mos aprovimit të kërkesës në fjalë, ankuesi me datë 19.07.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimi se udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt ka shkelur të drejtën e garantuar me ligj për pushim vjetor, me rastin e mos aprovimit të kërkesës të datës 13.06.2023. Shton së nuk ka pranuar ndonjë email nga Kryeshefi Ekzekutiv së është pjesë e ndonjë grupi punues apo ndonjë plan të aktiviteteve të punës për muajin qershor. Kërkon që Këshilli

të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të njihet e drejta e shfrytëzimit të pushimit vjetor të bartura nga vitit 2022 ose që ti bëhet kompensim në ndonjë formë tjetër bazuar në rregullat ivën në fuqi.

Kolegji thekson faktin së në vështrim të nenit 18 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, pushimet e zyrtareve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës. Ndërlidhur me këtë, rregullat e pushimeve të zyrtareve publik janë të rregulluara edhe me Rregulloren (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, e zbatueshëm deri me 12 tetor 2022, dhe Rregulloren (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, në fuqi nga data 13 tetor 2022.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i ‘u referua nenit 11 të Rregullosës (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, me të cilin është përcaktuar se: “*Zyrtari publik për çdo vit kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor me pagesë në një kohëzgjatje prej njëzet (20) ditë pune, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar... 3.Zgjatja e pushimit vjetor përcaktohet varësisht nga stazhi i punës, ku për çdo pesë (5) vite të përvojës së punës, shtohet një (1) ditë pune... 8. Zyrtari publik ka të drejtë, së paku një ditë e gjysmë (1.5) të pushimit, për çdo muaj kalendarik të kaluar në punë, nëse: 8.1. në vitin kalendarik në të cilin për herë të parë ka themeluar marrëdhënie pune, nuk i ka gjashtë (6) muaj të punës së pandërprerë; 8.2. në vitin kalendarik nuk e ka fituar të drejtën për shfrytëzimin e pushimit vjetor për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. 9. Ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor nuk mund të kompensohen me para. 10. Përjashtimisht paragrafit 9 të këtij neni, kompensimi me para i ditëve të pashfrytëzuara të pushimit mund të bëhet në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Në këtë rast, kur institucioni nuk mund të sigurojë shfrytëzimin e ditëve të mbetura të pushimit për zyrtarin publik, i njëjti do të kompensohet me pagesë të kalkuluar për ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor...”* Ndërsa nenin 11 paragrafi 4 dhe 5 të kësaj rregullore ka paraparë se: 4. *Në qoftë se zyrtari publik e shfrytëzon në dy (2) apo me shume pjesë pushimin vjetor, pjesa kryesore duhet të shfrytëzohet për së paku dhjetë (10) ditë pune të pandërprera gjatë një (1) vitit kalendarik. 5. Pjesa tjetër e pushimit të pashfrytëzuar duhet të shfrytëzohet jo më vonë se deri me 30 qershor të vitit të ardhshëm kalendarik...”* rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji konstaton së e drejta në pushim vjetor është e drejtë ligjore e çdo nëpunësi civil, e cila duhet të shfrytëzohet në pajtim me procedurat e përcaktuara me depozitat ligjore të aplikueshme, andaj, mbi këtë bazë, e duke ju referuar provave të lëndës, Kolegji vlerëson së refuzimi i kërkesës së ankuesit për shfrytëzimin e ditëve të pushimit vjetor të bartura nga viti 2022, prej shtatë (7) ditëve, mbi bazën e rrethanave si në përgjigjen në ankesa, është në kundërshtim me nenin 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, me të cilin është theksuar se: ***Të punësuarit nuk mund t’i mohohet e drejta në shfrytëzimin e pushimit vjetor.***

Për më tepër, Kolegji për vendosje meritore mori parasysh faktin e pa kontestueshëm së Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka të miratuar Projektin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Shtëpiake dhe Banesave (RPESHBA), i cili projekt planifikohej të filloj së zbatuari nga data 01.09.2023 deri me 16.10.2023, mirëpo, përkundër këtij Plani, Agjencia e Statistikave të Kosovës, deri në kohën e parashtrimit të kërkesës së ankuesit për pushim vjetor të datës 13.06.2023, nuk ka pas të miratuar ndonjë plan të shfrytëzimit të pushimeve të stafit siç përshihet me nenin 11 paragrafi 6 të Rregullosës (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, dhe se ankuesi nuk kishte pranuar ndonjë njoftim lidhur përfshirjen e tij në planin për regjistrimin e popullsisë, rrjedhimisht nga shkresat e kësaj çështje juridiko administrative, Kolegji nuk ka gjetur së Agjencia e Statistikave të



Kosovës ka të miratuar Planin e punës lidhur me zbatimin e Projektit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Shtëpiake dhe Banesa, i cili ndër të tjera do të specifikonte edhe rolin dhe përgjegjësitë e çdo zyrtari, e në rastin konkret edhe të ankuesit, veprim ky që do të arsyetonte edhe aplikimin e kufizimeve në shfrytëzimin e pushimeve vjetore të stafit, qofte të batuara nga viti paraprak apo edhe të vitit ekzistues.

Bazuar në gjendjen faktike dhe bazën ligjore të theksuar me sipër, Kolegji duke bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të aprovohet si e bazuar ankesa e ankuesit, duke obliguar Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesit t'i njoh të drejtën e shfrytëzimit të shtatë (7) ditëve të pushimit vjetor të bartura nga viti 2022, në periudhën e mbetur të vitit 2023.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1005/2023.

Ardita Percuku Shyti

*Procesmbajtëse*



Ardita Haxhnikaj-Demi

*Kryetare e Kolegjit*

### Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjenci e Statistikave të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

